



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Krijimi i një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota (Joint Venture) nga Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmBh dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi në lidhje me krijimin e sipërmarrjes së përbashkët (Joint Venture) me funksione të plota në Gjermani nga ana e Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, MHP Management und IT Beratung GmBh dhe Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft.

Palët në transaksion janë:

Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft, është një shoqëri e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit gjerman. **Dr.Ing. H.c.F.Porsche Aktiengesellschaft** së bashku me filialet e saj, operon në prodhimin, zhvillimin dhe shitjen kryesisht të makinave sportive dhe automjeteve për qëllime tregtare, si dhe ofron shërbime financiare për automjetet, duke përfshirë marketimin e shërbimeve të konektivitetit, nëpërmjet markës ndihmese MOIA.

MHP Management është një filial i zotëruar nga Porsche, një shoqëri konsultimi e specializuar në shërbimet IT dhe konsulentë në sektorët e automjeteve dhe prodhimit.

Mynih Ruckversicherungs-Gesellschaft është një shoqëri gjermane risigurimi, e cila ka për objekt shërbimet e sigurimit, duke mbuluar të gjithë zinxhirin e vlerës së risigurive, sigurimeve parësore dhe zgjidhjet e riskut të sigurimeve.

Palët e mësipërme, së bashku, do të krijojnë një shoqëri të përbashkët, me funksione të plota (joint venture), në sajë të së cilës do të behet zhvillimi i konceptit, konsulencës dhe shërbimit dhe shitjen e tyre në lidhje me konceptet fleksibel dixhitale të prodhimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.